

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale ndërtimi për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2023”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

441100000-4 Materiale ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

3 962 494 (tre milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër)
lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Çorovodë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 8;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Ky kriter është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm të pikës 2.2.2 është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit).

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën "a",

“b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese te ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njohura me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknike:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit të mallrave objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 4 (katër) persona** .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- Listpagesat sipas formularit satandart për sigurimet
- Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Nisur nga mallrat objekt kontrate të cilat janë parashikuar në preventiv që do të dorëzohen në destinacione të ndryshme, sipas përcaktimeve të kryera nga AK, nevojiten 2 (dy) punonjës duhet të jenë si drejtues të automjeteve 2 (dy) punëtor ngarkim shkarkimi.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë *Leje mjedisore kodi III.1.B (Leje e vendosur jo më larg se 50 km nga Bashkia Skrapar)*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik **si dhe ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”** i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë realizimin me sukses të kontratës si dhe kërkesës së AK duke qënë se kjo Ndërmarrje nuk ka një vend magazinimi .

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi, raportin e testimit ose/dhe raportin e analizave ose/dhe skedë teknike, ku të pasqyrohen të gjitha karakteristikat e produktit , me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të faktojnë specifikimet teknike dhe AK të verifikojë pajtueshmërinë e këtyre specifikimeve me ato të kërkuara në DST.

2.3.5 Deklaratë nga Operatori Ekonomik që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e këkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *i ndryshuar* , ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të

kontratës, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë realizimin me sukses të kontratës si dhe kërkesës së AK .

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet si më mëposhtme:

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me kapacitet 20 -25 T	1 copë	Pronësi ose me qera

Për të dëshmuar këtë, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nese janë në pronësi, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit teknik, policen e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit te kontratës)
- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nese janë me qera, duhet të paraqiten dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, kontrata noteriale e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, policia e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit të kontratës)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e makinerive te sipërpërmendura.

Janë kërkuar këto makineri në përputhje me volumet e zërave të preventivit.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm te pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhes i vetedeklarimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT